VENDIM
Nr.62, datë 2.11.2005

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike ", si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 13.05.2004 "Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", me ndryshimet përkatëse, neni 11, germa A dhe neni 22, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 2.11.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria WTS Energji sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike, për shoqërinë WTS Energji sh.p.k.

2. Ngarkohet Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve për zbatimin e këtij vendimi, dhe të informojë shoqërinë WTS Energji sh.p.k. për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, në zbatim të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, si dhe vendimit nr.60, datë 29.12.2005 të Bordit të Komisionerëve " Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema